

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENE

PROJEKTI: Rikonstruksioni i rruges se re dhe rruges "Ago Celi dhe rikonceptimi i palestres. (Loti 2) Tepelene

Faza Projekt-Zbatimi

RAPORTI TEKNIK

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1.1 Hyrje**
- 1.2 Pozicioni i objektit**
- 1.3 Gjëndja Ekzistuese**
- 1.4 Studimi Topografik**
- 1.5 Projekt-Zbatimi**
 - 1.5.1 Rruga**
 - 1.5.2 Rrjeti K.U.SH.**
 - 1.5.3 Sistemi i Ndriçimit Rrugor**
 - 1.5.4 Sistemi i Linjave Rezerve**
 - 1.5.5 Sinjalistika Rrugore**



1.1. HYRJE

Rrethi i Tepelenes. Tepelena është qytet dhe kryeqendër e rrethit me të njëjtin emër në jug të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe prej 817 km². Tepelena ka një popullsi rreth 55 mijë banorë (2005) e cila jeton në dy qytetet Tepelenë e Memaliaj dhe në fshat, në tetë komuna me 35 mijë banorë. Rrethi përfshin pjese nga krahinat e Kurveleshit, Lopësit, Rrezes, Dervenit, Buzit e Krahësit



1.2. POZICIONI I OBJEKTIT

Objekti : Rikonstruksioni i rruges se re dhe rruges "Ago Celi dhe rikonceptimi i palestres. (Loti 2) Tepelene

Vendodhja : Bashkia Tepelne Rruga e Xhamise

1.3. GJENDJA EKZISTUESE

Gjendja ekzistuese

Me nje siperfaqe prej 1850m² sheshi perfshin fushen e minifutbollit dhe nje strukture ekzistuese 1kateshe (te degraduar dhe mjaft te demtuar).

Godine e ndertuar para viteve 90' ne gjendje shume te keqe konstruktive. Distanca e afert me qendren e qytetit, zonen e banuar dhe shkollat e qytetit e ben nje hapshire mjaft te favorshme per funksionin e nje fushe lojrash polifunksionale. Sheshi eshte i orientuar Lindje-Perendim. Aksesin ne shesh realizohet permes rruges se xhamise, ne pjesen lindore te tij.



Godinat qe kufizojne sheshin kane nje lartesi 1-2 kate duke mundesuar djellezim te sheshit gjate gjithes dites. Niveli i ndotjes akustike nuk eshte ne nivele shume te larta pasi "Rruga e Xhamise" eshte nje rruge dytesore me nje fluks jo shume te madh qarkullimi te automjeteve.



Fusha ekzistuese e minifutbollit është në gjendje të mirë por ka nevojë për disa riparime dhe realizimin e një mbulëse për ta mbrojtur nga agjentët atmosferik dhe rreshjet e shiut.

Rruga e Xhamisë është aksë I vetëm hyrës dhe qarkullues I sheshit. Sipërfaqja e saj është shumë e dëmtuar. Mungesë trotuaresh dhe infrastrukture rrugore. Godinat përreth me lartësi 1-2 kate janë kryesisht vila banimi. (në veri sheshi kufizohet me Xhaminë e qytetit, në perëndim me 1 godinë 2 kateshe dhe në jug me një godinë 1 kateshe. Sheshi është një hapësirë urbane e hapur vizualisht.

1.4. RELACION TOPOGRAFIK


“Palester Sportive ,Salle Lojrash Polifunksionale”

1.4.1. Hyrje dhe Pozicioni gjeografik i rruges

Në respektim të termave të referencës të projektit të sipërcituar:

“Raporti përfundimtar i Punimeve Topografike duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projekt zbatimit si dhe të asaj të fazës së zbatimit të punimeve. Në këtë fazë konsulentit do të paraqesë një raport të saktë të vendodhjes së pikave kryesore të vendosura prej tij për zbatimin e punimeve. Sistemi i referimit të jetë i pranuar në bazë të standarteve në

fuqi punimet topografike filluan nga rikonicioni dhe njohja me vendin ku do te realizohet objekti.



Palester Sportive ,Salle Lojrash Polifunkionale

1.4.2. Instrumentat dhe metodeologjia

Zgjedhja e instrumentave dhe aparaturave

Duke njohur tashme karakteristikat e situates urbane , e cila ne teresine e saj eshte zone me dendesi urbane te larte dhe vizualitet te kufizuar, Grupi topografik zgjodhi dhe operoi ne terren me Total Station " TRIMBLE " Geodimeter 5503, si per ndertimin e rrjetit mbeshtetes dhe kompletimin e detajeve te relievit .

Karakteristikat fiziko - teknike te kesaj aparature si dhe sakesite e garantuara ne percaktimin e pozicionit te pikes, se bashku me kompatibilitetin e perpunimit te te dhenave ne programet compjuterike si edhe metodika e matjes , garantojne sakesine e kerkuar nga parametrat teknike te projektimit dhe te zbatimit.

Sistemi i referimit, ne plan, duke respektuar standartet ne fuqi, eshte zgjedhur

Lokal (Northing 5000.00, Easting 5000.00)

Referenca altimetrike eshte pranuar Lokale, duke i dhene **kuoten 100,00 m** pikes fillestares **BM 1** (Benchmark)

Te dhena teknike e instrumentit Total Station TRIMBLE 5503

Gabime instrumentale

Matjet

Vlerat

Matje gjatesore Standart	$\pm 0.003 \text{ m} + 3 \text{ ppm}$
Matje gjatesore Standat(e pershpejtuar)	$\pm 0.008 \text{ m} + 3 \text{ ppm}$
Matje kendore (deviacioni standart DIN 1873)	$\pm 3'' (1.0 \text{ ogon})$

1.4.3. Ndertimi i rrjetit mbeshtetes ne terren

Pozicionet e pikave mbeshtetese u zgjedhen pervec kriterit teknik , (ne vende te hapura dhe me shikim hapsinor te kenaqshem dhe gjatesi te pranueshme) u tregua kujdes edhe zgjedhjen e pozicioneve sipas mundesise locale dhe lehtesisht te identifikueshme si dhe strukturave te qendrueshme, kryesisht bordure trotuari, sheshe betoni , duke u fiksuar me gozhde betoni. Ne vendet me pak te sigurta fiksimi i poligonaleve do te realizohej me shufra hekuri te ngulura ne toke 30-40 cm

Skema e rrjetit mbeshtetes (Poligonometria)

Koordinatat e pikes BM 1 (Beanch Mark) X 5000.00 , Y 5000.00, u pranuan si koordinatat fillestare te te gjithë rrjetit mbeshtetes qe do te ndertohej per gjithë rilevimin e zones.


Sistemi altimetrik referues u pranua kuota 95.24 m mbi piken e fiksuar (BM 1)

Ne Ndertimin e rrjetit te pikave te poligonometrise eshte mbajtur ne konsiderate edhe sherbimi qe do realizojne keto pika gjate zbatimit te punimeve si referenca mbeshtetese per zbatimin e punimeve

Rrjeti mbeshtetes per vete shtrirjen pergjate nje segmenti rrugor , konfiguror skemen e poligonit te hapur. Poligonometria u mat me metodiken vajtje ardhje Perfundimet e ketyre matjeve rezultuan brenda saktetise se garantuar , DHE SAKTESUAM KOORDINATAT PERFUNDIMTARE TE PIKAVE TE RRJETIT MBESHTETES MBAS PERFUNDIMIT TE MATJEVE NE POLIGONOMETRI KALUAM NE RLEVIMIN E ZONES.

Poligonometria perbehet gjithsej nga 25 pika referuese nga te cilat nje eshte pika baze (bm 1) dhe te tjerat poligone pune. Pavaresisht nga cilesimi i tyre te gjitha pikat garantojne saktesine :


Horizontal
Vertical



1.5. PROJEKT-ZBATIMI

1.5.1. Palester Sportive


Konstruksioni I godines eshte nje strukture e kombinuar,ku muret,traret,kolonat dhe soleta e katit perdhe jane realizuar me konstruksion beton-arme. Kolonat me permasa 40cm x 40cm dhe lartesi maksimale 950cm . Muret perimetrale mure tulle 45cm (Mur Tulle 25cm –Shtrese Polisteroli 8cm – Mur Tulle 12cm) dhe soleta e dyshemese ,solete beton arme 30cm.




Konstruksioni I godines (Themele,Trare,Kolona,Soleta,Shkallare) beton arme
Muret perimetrale : Mur Tulle 25cm –Shtrese Polisteroli 8cm – Mur Tulle 12cm
Konstruksioni mbajtes I mbuleses : Kapriate metalike (celik)
Mbulesa : Polikarbonat I bardhe / Shtrese izoluese

Mbulesa eshte e perber nga 2 shtresa, Struktura mbajtese dhe shtresa e mbuleses.

a)Struktura eshte realizuar me kapriata metalike harkore cdo 605cm (mbi cdo kolone) sipas drejtimit terthor dhe cdo 540cm sipas drejtimit gjatesor. Lartesia e kaprites 120cm. Kapriatat lidhen me kolonat beton-arme ne pjesen fundore te tyre permes kapjeve me bulona metalike.




b)Mbulesa perbet nga 2 shtresa,shtresa izoluese dhe mbulesa e siperfaqes se jashtme me polikarbonat. Forma e harkuar e mbuleses ofron avantazhin e kullimit natyral si rrjedhoje e pjerresise se saj. Ne pjeset fundore (faqja veriore dhe jugore) do te realizohen 2 tuba metalik me pjerresi te dyfishte te cilat do te percjellin ujrat e shirave ne nivelin e ullukeve metalik (U1,U2,U3,U4) te cilet do te percojn ujrat ne nivelin e trotuarit (kuota -0.60) drejt rrjetit te kanalizimeve te ujrave te shiut.




Prerje Gjatesore 1-1

Sh 1:120



Ne nivelin e mbuleses jane realizuar 8carjae (dritare) me gjeresi 100cm dhe me gjatesi te ndryshme (9m-9m-8,5m-8m-7m-6-4m-3m) te cilat do te mundesojne ndricimin natyral te hapësirës së brendshme gjatë orareve të ditës kur fasada kryesore (faqja lindore e objektit) të mos ketë ndricim natyral. Carjet janë realizuar me dopio xham struktural të izoluar në kornizat anësore kundrejt urjave të shiut.



-Interieri / Materiale dhe Rifinitura


Sipërfaqja e fushes rekomandohet të shtrohet me parket elastik, në mënyrë që aktivitetet sportive që do të zhvillohen në palester të jenë sa më komode dhe për të shmangur dëmtimet e personave që do ta shfrytëzojnë atë. Për efekt vizual por edhe estetik sipërfaqja anësore perimetrale e fushe me gjatësi 2m është projektuar me një ngjyrë të ndryshme nga ajo e parketit brenda vijave të fushes së basketbollit (15m x 28m).

Fusha e lojës : Parket Druri blu në pjesën anësore perimetrale-parket i verdhë në hapësirën e fushës së lojës 28m x 15m

Stola plastik : të vendosur në shkallaren anësore me dimensione 45cm x 45cm – 225copë

Ndricues gjatesore Led : me permasa 30cm x 150cm, në nivelin e pjesës së poshtme të kapriatës për të realizuar ndricimin e ambientit gjatë natës.

Shtrese gome elastike : për të amortizuar goditjet dhe kontaktin direkt me faqen e murit






-Perkrah palestres pozicionohet edhe fusha e minifutbollit ekzistuese. Propozimi parashikon zvogelimin e dimensioneve te saj (45m x 25m) ne dimensionet e reja 39m x 24m (standart per fushat e minifutbollit 5x5 ose 6x6 (10 ose 12lojter ne fushe). Propozimi parashikon krijimin e nje shkallareje me 2rreshta pergjat Rruges se Xhamise duke izoluar edhe hapesiren e fushes nga rruga. Ne kete segment eshte pozicionuar hyrja e fushes.



Koridori majtas te drejton permes shkallares ne dhomat e zhveshjes (ne nivelin e podrumit te palestres). Fusha e lojes ka dimensionet 37m x 21m (150cm hapësira anësore perimetrale). Propozimi parashikon edhe realizmin e nje mbulese per fushen e minifutbollit ku lartësia minimale e hapësires do te jete 8m (normative e detyrueshme per futbollin indoor).

Open
Procurement
Albania


Rruga "E RE" me gjatësi totale 183.179 ml. Trupi i rruges eshte me gjerësi 3.5m. kjo tregohet ne prerjet e meposhtme. Kuneta me bllok betoni 60x40 cm ne nje ane 0.5m



Rruga "E RE"

Open
Procurement

PROFIL TERTHOR TIP 4 SH. 1:50
(Rruga e Re Nga KP 0+000 ne KP 0+180)



Pllakat do jenë gurii me trashesi 4cm.

Në fillimet dhe fundet e çdo segmenti, si dhe në vendet e kalimit të këmbësorëve në rrugë, trotuari do të ndërtohet i ulur, për të bërë të mundur, lëvizjen lirshëm për njerëzit me aftësi të kufizuara, karrocave të fëmijëve etj.

Gjatë realizimit të shtresave, detyrimisht të respektohet cilësia e materialeve dhe kërkesat për kompaktësim, në përputhje me specifikimet teknike.

Bordurat dhe Kunetat

Trupi i rrugës do të kufizohet me bordurë guri 20x30 cm . Kunetat do të jenë me bllok beton me gjerësi 50cm. Kuneta do të ketë trashësi mesatare 10cm. (me këtë realizohet pjerrësia tërthore e kunetës.

Në trotuare, pranë kryqezimeve, në vendet e kalimit të këmbësorëve janë parashikuar dhe rampat për kalimin njëzë me aftësi të kufizuara.

Rruga “**Xhamise** ” me gjatësi totale 100 m. Kjo është rrugë me dy kalime. Gjerësia totale e saj është 9m me kunete në dy anët e rrugës.

Pllakat do jenë guri me trashësi 4cm.

Në fillimet dhe fundet e çdo segmenti, si dhe në vendet e kalimit të këmbësorëve në rrugë, trotuari do të ndërtohet i ulur, për të bërë të mundur, lëvizjen lirshëm për njerëzit me aftësi të kufizuara, karrocave të fëmijëve etj.


Gjatë realizimit të shtresave, detyrimisht të respektohet cilësia e materialeve dhe kërkesat për kompaktësim, në përputhje me specifikimet teknike.

Bordurat dhe Kunetat

Trupi i rrugës do të kufizohet me bordurë guri 20x30 cm . Kunetat do të jenë me bllok betoni me gjerësi 50cm. Kuneta do të ketë trashësi mesatare 10cm. (me këtë realizohet pjerrësia tërthore e kunetës.


Në trotuare, pranë kryqezimeve, në vendet e kalimit të këmbësorëve janë parashikuar dhe rampat për kalimin njëzë me aftësi të kufizuara.

PROFIL TERTHOR TIP 1 SH. 1:50
(Rruga e Xhamise Nga KP 0+000 ne KP 0+112)



Rruga "Xhamise"





1.5.2. Rrjeti i KUB

Projekti parashikon ndertimin e nje rrjeti te vecante dhe te pavarur te ujerave te bardha nga ai i ujerave te zeza, duke lehtesuar keshtu punen e rrjetit te K.U.Z. Dimensioni minimal i linjave qe do te reabilitohen eshte pranuar Dj 315 mm, ne menyre qe mirembajtja dhe pastrimi i rrjetit te jete me i lehte dhe i menaxhueshem.

Ne te tre rruget rrjeti i KUSH eshte Dj 315 mm .

Konceptimi i rrjetit te ujerave te bardha eshte bere duke ruajtur parimin e ndarjes se ujerave te zeza nga ato te bardha. Sistemi i largimit te ujerave te bardha eshte

konceptuar kryesisht ne ndertimin e pusetave te shiut per largimin e ujerave te bardha ne trupit te rruges (ne kuneta).

Shkarkimi i ujrave te shiut per behet ne kolektorin ekzistues.



1.5.3. SISTEMI I NDRIÇIMIT RRUGOR

Ne kete projekt-zbatimi prashikohet ndertimi i ndricimit rrugor ne te gjithe gjatesine e rruges.

Per sisteme te tilla rruges me trafik te perzier dhe ne zona periferike rekomandohet qe fluksi mesatar i ndricimit te mos i kaloje 20 lx, si dhe te mos jete me i vogel se 8 lx.

Per rruget kryesore, per keto kushte zgjedhim tipin e shtylles qe do te jete shtylle dekorative me dy krahe me lartesi 5 ml. Keto shtylla do te vendosen ne te gjithe gjatesine e rruges ne anen e majte. Gjatesite e kraheve do te jene 1.5 ml. Shtylla do te jete e vendosur trotuar, brenda bordures se betonit qe kufizon ate.

Distanca ndermjet dy shtyllave do te jete rreth 25 ml.

Furnizimi me energji i ndricimit rrugor do te behet nga kabinat ekzistuese te zones.



1.5.4. LINJAT REZERVE

Ne projekt janë parashikuar vendosja e linjave rezerve. Linjat janë të vendosura nën trotuare në thellësi 80cm. Secila linjë, përbehet nga kater tubacione D=150 P.V.C. me t=3mm kjo per mbrojtjen e tubave nga demtimi i presionit te mjeteve. Linjat rezerve jane parashikuar ne trotuarin e anes se majte dhe anes se djathte.

1.5.5. SINJALISTIKA RRUGORE

Në Projekt-Preventivin e sinjalistikës është parashikuar Sinjalistika horizontale dhe ajo vertikale ne perputhje te plote me MPRrSh 6.

Rruga do te paiset me te gjithë vizimin e duhur horizontal, ky vizim eshte parashikuar te jete bikomponent.

Vizimi anesor eshte me gjeresi 15cm ndersa vija e ndarjes se drejtimeve eshte me gjeresi 12cm.

Ne kryqezimet kryesore eshte parashikuar vendosja e vizimit perkates per kalimin e kembesoreve, 0.5m.

Të gjitha tabelat do vendosen në trotuare, ngjitur me bordure kufizuese të tij.

Persa i përket sinjalistikës vertikale në projekt është parashikuar vendosja e tabelave vertikale rrethore 60cm (cl 2) të cilat detyrojnë uljen e shpejtësisë në 40km/h në këtë segment rrugor.

INFRAKONSULT SH.P.K

Drejtuesi Ligjor

Ing.Redë Struga

